

VENDIM
Nr.525, date 30.7.2004

**PER PROCEDUREN E APLIKIMIT PER REGJISTRIMIN E LENDEVE PLASESE
NE REGJISTRIN SHTETEROR TE LENDEVE PLASESE PER PERDORIM CIVIL**

(Ndryshuar me vendimin nr. 963, datë 02.12.2015)

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te nenit 8 te ligjit nr.9126, date 29.7.2003 "Për përdorimin civil te lendeve plasëse ne Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit te Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të regjistrit shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili të hapet dhe të mbahet në Ministrinë e Mbrojtjes.

1.1 Komisioni i dhënies së licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, dërgon një kopje të licencës së miratuar në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, si dhe çdo tre muaj, dërgon pranë kësaj ministrie, një kopje të regjistrit të lëndëve plasëse për përdorim civil, me të dhënat e subjekteve të regjistruara në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse¹.

2. Çdo subjekt, që prodhon, eksporton dhe importon lëndë plasëse është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të aplikojë për regjistrimin e sasisë së këtyre lëndëve në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse.

3. Në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse regjistrohet edhe çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim, nga ana e prodhuesit dhe importuesit.

4. Subjektet qe aplikojnë janë te detyruara te paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) Fotokopje të noterizuar të lejes së importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.
- b) Adresën e saktë të personit juridik ose fizik (tel/fax, celular).
- c) Proform-faturën nga uzina prodhuese, me llojin dhe sasi të lëndëve plasëse, për subjektet importuese.
- ç) Dokumentin vërtetues të llojit, sasisë së lëndëve plasëse, për subjektet që prodhojnë dhe eksportojnë.
- d) Dokumentet teknike, që i përkasin tipit të miratuar.
- dh) Një kopje të certifikatës ekzaminuese, EC.

5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

¹ Shtuar me pikën 1, të vendimit nr. 963, datë 02.12.2015

